



DIREKTORIJA E ADMINISTRATËS PËR SHTJETHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izazna

Nr. 11- 599
Br.

Data 03.06.2019
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality of Obiliq

Në mbështetje të nenit 9. Pika 1.4 të Udhëzimit administrative nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL - për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), thërras mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Obiliqit- me dt.18.06.2019 (e martë) në ora 10:00 në sallën e KK-së, me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Gjendja e sigurisë në Komunën e Obiliqit
4. Të ndryshme

Kryetari i KKSBB

Xhafer Gashi





Dalës Izazhë
Nr. 11-600 Br. Datum 03.06.2019
OBILIO-OBILIĆ



Republika e Kosovës- Republika Kosovo- Republic of Kosova

Komuna Obilić - Opština Obilić - Municipality Obilić

EKSTRAKT NGA PROCESVERBALI

I mbledhjes së II-të të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Komunën e Obiliqit, të mbajtur më 07.05.2019 në ora 10:00 , në sallën e KK-së.

Në mbledhje morën pjesë këta anëtarë: Kryetari i Komunës-Xhafer Gashi, Komandanti i SP-Sejdi Zeqiri, përfaq. i FSK-major I.Demiri, përfqaq.i komun.ortod. -Naspaliq Aleksander, përf.kom.serb.- Slavisha Jakovljeviq, përfqaq.i komun.boshnjak-Lejla Boshnjak, drejtor i DMM-Arben Berisha, drejtori i DA -Agim Spahiu, Kryetari i KLSP-sekt.I-re-Burim Gërguri, përf.i Kësh.të prind.-Fatmir Bërbatovci, përf.kom.rom-Shaban Berisha, zyrtari i emergj.-Valon Berisha, Qendra Rinore-Zelushe Kelmendi, Eljesa Tërbunja-Handikos, EVSB-Sejdi Haxholli, OJQ "Aureola"- Sanije Graçevci, ZKKK- Sllavisha Agjanqiq, Kryetar i K. Komun. - Avdyl Mustafa, përfqaq.i kom.malaz.-Jasmina Radanoviq, zyrt.baraz.gjinor-Ganimete Aliu dhe koordinator i KKSBB - S. Hashani.

Munguan: perf.i BIK-Behar Mjekiqi,

Prezent të tjerë: përfqaqësues të KFOR-it dhe OSBE-së.

Mbledhjen e KKSBB-së e udhëhoqi Kryetari i Komunës – Xhafer Gashi, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe konstatoi se ka kuorum për të filluar mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Gjendja e sigurisë në Komunën e Obiliqit
4. Të ndryshme

Kryetari- Pasi i përshëndeti të pranishmit për këtë mbledhje propozoj r.d. i cili u aprovua njëzëri.

I. Pika e parë e rendit të ditës.

Mungoi : perf.i BIK-Behar Mjekiqi.

II. Pika e dytë e rendit të ditës-

Pasi nuk pat vërejtje nga të pranishmit njëzëri:

Aprovohet procesverbalı nga mbledhja e kaluar njëzërit pa vërejtje.

III. Pika e tretë e rendit të ditës-

Komandanti i SP-S. Zeqiri- të pranishmit i njoftoi se situata e sigurisë në Komunën e Obiliqit është relativisht e qetë dhe stabile edhe përkundër stafit të ultë të zyrtarëve policor në SP.

Në dy muajt e fundit i kemi këto raste, si vijon:

- kemi pasur një kanosje ku njeri ka qene nga Prishtina e tjetri nga fshati Kozaric,K. Obiliqi, i kemi ndërmarr te gjitha veprimet e nevojshme konform ligjit dhe personin e dyshuar e kemi arrestuar, dhe pastaj e kemi kontrolluar shtëpinë e te dyshuarit me autorizim te prokurorit në Dragodan. Kemi gjetur disa armë të ftohta dhe te nxeha si dhe kemi gjetur substanca narkotike, ndaj personi te dyshuar është ushtruar kallxim penal dhe është dërguar ne paraburgim prej 30 ditësh.
-Në Mazgitë kemi pasur konflikt mes dy vëllezërve lidhur me konteste pronësore ku njeri vëlla është me te meta psikike. I kemi marr te gjitha veprimet dhe kemi shkuar ne shtëpinë e vëllait tjetrit dhe kemi gjetur 3 arme te kalibrit te ndryshëm cilat i kemi konfiskuar dhe personi i dyshuar është ne paraburgim.

- ne muajin e fundit para reshjeve atmosferike kemi pasur zjarrvënie ne tere Kosovën 150 raste por ne komunën tone kemi pasur një rrënje me te vogël ne fshatin Breznicë kemi pasur zjarrvënie te pyllit dhe shume shpejt kemi reaguar dhe ndaj tij është ushtruar kallxim penal.

-ne Plementin pas një zënke ne gjendje te dehur kemi pasur zjarrvënie, ku një person i dehur i ka djegur dy shtëpi, i kemi ndërmarr te gjitha veprimet e duhura. Personi i dyshuar është arrestuar ndërsa familjeve qe ju kane djegur shtëpitë ju është rekomanduar qe te drejtohen Qendrës për Pune Sociale por dyshojmë se zjarrvënia është bere me qellim qe familjaret qe gjenden jashtë për te kërkuar azil ne vende tjera.

-ne po angazhohemi edhe për sigurinë e KEK-ut edhe pse ata e kane sigurinë e vete për shkak te qenve endacak.

- kemi ankesa nga qytetaret për qentë endacak

- kemi pasur ekskursione të nxënësve te shkollave te mesme si dhe mbrëmjen e maturës, te cilat kane kaluar mire dhe pa incidente dhe po vijnë ne përbyllje te shkollave te mesme dhe ato fillore

- ne fshatin Lajthishte po kemi incidente mes nxënësve dhe arsimtareve mire kishte me qene mu marr me shume DA-ja qe te reduktohet ky problem

- ne fshatrat multietnike Babimost, Plementin dhe Palaj kemi vazhduar patrullimet por nuk jemi te kënaqur me vozitësit e automjeteve dhe propozoji qe inspektoret komunal se bashku me policinë te dalin neper pikat te ndryshme dhe ti kontrollojnë shenjat sepse po dëmtohen apo po largohen për arsyte te ndryshme .

-me 20 te këtij muaji kemi një kërkesë për zhvarrosjen e një te vdekuri ne v. 1990 te kombësisë serbe dhe zhvendosjen e tij nga Obiliqi në R. Serbisë, për ketë ekziston njësia qe do te mbikëqyret edhe nga inspektori sanitari komunës..

Slavisha Agjanqiqi- lidhur me rastin ku janë djegur 3 shtëpi (dy janë vëllezër ndërsa e i treti është djali i axhës) te trete familjar i takojnë familjes Kurta. Jemi duke e pritur raportin re policisë ndërsa ne mandej do te dalim me raportin komplet. Dy familjar gjinden ne Gjermani ndërsa i treti është këtu. Ne jemi duke u munduar te gjemë donator për renovimin e shtëpive.

Slavisha Jakovljeviq- sipas raportit te komandantit te SP-se jemi me fat qe nuk kemi konflikte ndëretnike dhe për ketë e falënderojmë policinë.

- Lidhur me rastin ne Plementin presim konstatimin nga raporti policor .
- Ne mes tjerash tha se do t'i drejtohem me shkresë policisë përritjen e stafit te policeve te komunitetit pakice.
- Kërkoj qe te bëhet regjistrimi i bizneseve qe shesin alkool.
- ne mbledhjen e kuvendit te komunës te bihet vendim se kur mundet te përdoret alkooli dhe te evidentohen lokalet përshtiten e alkoolit.
- në rrugën Hamidi-Plementin eshte ndërtuar urra, rruga dhe tanë duhet te vendosen shenjat e komunikacionit dhe sipas mundësive te behet vendosja e policit te shtrire.

Komandanti i SP-S. Zeqiri- sa i përket shtëpive te djegura tha se janë dy shtëpi ndërsa familjarët gjenden jashtë Kosovës ndërsa është identifikuar personi qe e ka kryer zjarrvenien. Ndesa sa i perket raportit te policisë , i njëjti i është dërguar ne prokurori. Sa i përket kafeve ne Orlloviq është hapur lokal me muzike por kjo është çështje qe i takon inspektoret komunal. Ne Plementin janë 2-3 lokale qe funksionojnë por a kane leje apo jo edhe kjo i takon inspekzionit komunal.

Kryetari- pasi ju falënderua për kontributin e dhëne , tha se sa i përket sinjalizimit horizontal-vertikal janë duke u kryer këto pune,

- sa i përket shtëpive te djegura për ketë është policia,
- lidhur me alkoolin- do te diskutojmë ne takimin e radhës me ispektionin

IV. Të ndryshme

Elesja Terbunja- propozoj qe mundësishet te largohen grafitet nga muret ne qytet, këtij propozimi ju bashkëngjit edhe **Zelushe Kelmendi** e cila tha se kur ishte ne Plementin te ish-objekti i komunës, figuronin ende mbishkrimet nga paralufsta dhe është mire te largohen për shkak te mbajtjes se aktiviteteve.

Takimi përfundoji në ora 10:37.

Koordinatore-Procesmbajtës
S. Hashani

Kryesuesi i KKSB-së
Xhafer Gashi

